



Planuar / Doretuar Priljevit/Produkt Received/Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Hi Prot Hi Prot Prot.No	Shërbimi Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBETOR	1744/2022		1117



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE.SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Nr. 16 /2022

Datë:30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi lyp në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

**Jeton KOCA**  
  
**Kryetar i Këshillit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëjohë-Profilato Received / Delivery	30.03.2022	2	viti god year
Organi / Shërbimi Org. / Shit. Org. / Unit	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOCK	1714/2022		1/16



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**RAPORTI I MONITORIMIT**  
**PËR VITIN 2020**

*në*

**MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Prishtinë, 2022

## TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBAJTJE.....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	3-4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	4
FUSHA E MONITORIMIT.....	4-5
RAPORTI I MONITORIMIT NË MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	5-16

## HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i themeluar me Kushtetutë, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli, mandatin e tij kushtetues, *sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil* e realizon përmes funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si:

- ❖ *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- ❖ *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- ❖ *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- ❖ *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- ❖ *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë;*
- ❖ *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- ❖ *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- ❖ *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- ❖ *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- ❖ *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.*
- ❖ *Rregulloren Nr.05/2018, Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

### FUNKSIONI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil, Këshilli ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Ketë funksion e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullore Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksioni i monitorimit ushtrohet përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

## OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike Këshilli siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

## FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- ❖ Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- ❖ Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- ❖ Procedurat disiplinore;
- ❖ Procedurat e ankesave;
- ❖ Procedurat e vlerësimit;
- ❖ Procedurat e pushimeve;
- ❖ Procedurat e transferimit;
- ❖ Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- ❖ Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- ❖ Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- ❖ Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- ❖ Trajnimi i nëpunësve civil;
- ❖ Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- ❖ Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- ❖ Ngacmimet Seksuale;
- ❖ Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

## RAPORTI I PROCEDURËS SË MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL, NË MINISTRINË E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për të vlerësuar drejtë në mënyrë të pa anshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 01.02.2022, në prezencë të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

Rregullore (QRK) Nr.37/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me Organogram të Strukturës organizative të MBPZHR-së; Struktura etnike e stafit për muajin janar-dhjetor 2020; Plani individual vjetor i punës 2020; E-mail i datës 24.06.2021 lidhur me statusin e nëpunësve civil, me shkresat e bashkangjitura si dhe listën e nëpunësve drejtuar MPB me datë 24.06.2021; Vendim me numër protokolli 1002 dhe nr.ref.KM.50/20 i datës 27.02.2020 për caktim të ushtruesit të detyrës; Vendim me numër protokolli 1233 nr. 116 ref.ZSP-162/20 i datës 09.03.2020 për caktim të ushtruesit të detyrës; Vendim me numër protokolli 1515 nr.ref.KM.74/20 i datës 01.04.2020 për caktim të ushtruesit të detyrës; Vendim me numër protokolli 1525 nr.191 ref.KM.257/20 i datës 02.04.2020 të ushtruesit të detyrës të detyrës; Vendim me numër protokolli 2525 nr.ref.KM.116/20 i datës 01.07.2020 për caktim të ushtruesit të detyrës; Vendim me numër protokolli 2968 nr.ref.ZSP.714/20 i datës 24.07.2020 për caktim të zëvendësuesit të detyrës; Vendim me numër protokolli 2967 nr.ref.ZSP.712/20 i datës 24.07.2020 për caktim në zëvendësuesit në detyrë; Vendim me numër protokolli 2969 nr.548.ref.ZSP.713/20 i datës 24.07.2020 për caktim në zëvendësuesit në detyrë; Vendim me numër protokolli 4513 nr.ref.ZSP.1069/20 i datës 12.11.2020 për caktim në zëvendësuesit në detyrë; Lista e procedurave të rekrutimit dhe avancimit për vitin 2020; Lista e të punësuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta për vitin 2020, në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kërkesë me numër protokolli 428/7 i datës 28.04.2020 për ndërprerje të marrëveshjeve për shërbime të veçanta për vitin 2020; Procedurat e zhvilluara në komision disiplinor për vitin 2020 me vendimet e bashkangjitura; Vendimi me numër protokolluar 4056, Nr.ref. ZSP:969/20 i datës 13.10.2020, mbi themelimin e Komisionit Disiplinor; Kërkesë me numër protokolluar 4660, për Inicim i datës 18.11.2020, E-maili i datës 24.01.2022, Informim i datës 10.12.2020; Kërkesë me numër protokolluar 4996, për Inicim i datës 09.12.2020, Vendimi i datës 29.12.2020 nr. protokolli 4996/2; Vendimi Nr. protokolli 4857 i datës 03.12.2019 i Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, Vendimi Nr. protokolli 4347/6 i datës 18.12.2019 nr. ref.KZKA.04/19 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, Ankesë e datës 14.01.2020 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë me numër protokolluar 746 e datës 12.02.2020 për Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, Ankesë me numër protokolluar 720 e datës 11.02.2020 për Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, Vendimi Nr. protokolli 720/3 i datës 02.03.2020; Vendimi Nr. protokolli 4147/3 i datës 23.10.2019, procesverbal i datës 02.03.2020 ; Vendim i datës 02.03.2020 nr. protokolli 746/2 nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, E-mail i datës 14.04.2020, Përgjigje nr. protokolli 1598 në ankesë e datës 10.04.2020 ; Proceduar e vlerësimeve, E-mail i datës 15.09.2020, Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për periudhën nga data 05.12.2019 deri me datë 27.07.2020, kurse nga periudha shtator-dhjetor nuk gjendet në dosje gjatë vizitës së monitorimit, e cila është dërguar, në provat shtesë me datës 08.02.2020 nr.

Protokoli 478 nga Njësia e personelit të MBPZHR; Formulari i datës 06.10.2020, i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil, për periudhë provuese, pozita "Asistent Administrativ"; Formulari i datës 17.11.2020 i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil në periudhë provuese, pozita " Zyrtar për integritet Evropiane 2"; Formulari I datës 16.09.2020, i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil në periudhë provuese, pozita "Zyrtar për Arkiv"; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 24.06.2020, i nënshkruar me datës 29.01.2021, me Akte emërim Nr.659/2 të datës 12.03.2013 të bashkangjitur; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për periudhën janar-gusht 2020, i nënshkruar me datës 31.08.2020, Ndryshim dhe plotësim i Akt emërimit nr.3903 të datës 24.09.2019; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për vitin 2020, i nënshkruar me datë 29.01.2021, Akte emërimi nr. protokoll 1697 i datë 05.07.2013 pozita: Asistente; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për vitin 2020, i nënshkruar me datës 28.01.2021, me Akte emërim Nr.1756 të datës 12.07.2013 dhe Akte emërim Nr.4576 të datës 15.11.2019 të bashkangjitur, me planin vjetor individual 2020; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për vitin 2020 periudha janar -gusht 2020, i nënshkruar me datës 31.08.2020, me Ndryshim plotësim Akte emërim Nr.3903 të datës 24.09.2019; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për vitin 2020, i nënshkruar me datës 23.12.2020, me Akte emërim Nr.173/2 të datës 03.02.2014, të bashkangjitur, Vendimi Nr.1525/3 i datës 29.12.2020 për kthimin e nëpunës civil nga zëvendësimi në pozitën e mëparshme; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësin civil për vitin 2020, i nënshkruar me datës 23.12.2020, me Akte emërim Nr.3685 të datës 19.12.2012 të bashkangjitur dhe forma e përmbajtjes se dosjes se nëpunëses civile ne pozite Drejtore e Departamentit IE-se dhe Koordinim te Politikave ;Proceduar e pushimeve me nr. protokoll 848 i datës 18.02.2020, Raport i pushimeve vjetore, mjekësore për vitin 2020; Vendim me nr. protokoll 830/3 për pushim pa pagesë i datës 06.03.2020, për pushim të lehonisë; Njoftim nr. protokoll 932 i datës 09.03.2020, Vendim me nr. protokoll 3716/2 për shfuqizim të pushim lehonisë, i datës 16.09.2020, Vendim me nr. protokoll 1784 për shfuqizim të pushim lehonisë, i datës 07.05.2020( për pushim pa pagesë); Procedura e transferimit, Marrëveshje nr.ref:KE.281/20 i datës 31.03.2020, për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil, Vendimi nr. protokoll 1307 për transferim i datës 01.04.2020, Ndryshimi dhe plotësimi i Akte emërimit Nr.1770/5 i datës 06.05.2020, mbi transferimin e përhershëm; Vendimi nr. protokoll 2990 i datës 27.07.2020, për caktim të zyrtarit Certifikues, nga AZHB në MBPZHR-së; Vendimi nr. protokoll 1980/2 i datës 22.05.2020, për transferim të përkohshëm; Vendimi nr. protokoll 3436 i datës 28.08.2020, për transferim të përkohshëm (për 6 nëpunës civil) , nga AZHB dhe MBPZHR-së; Vendimi nr. protokoll 3436/2 i datës 09.12.2020, për transferim të përkohshëm (për 6 nëpunës civil), nga AZHB dhe MBPZHR-së; Vendimi nr. protokoll 2989 i datës 24.07.2020, për transferim të përkohshëm (për 10 nëpunës civil), nga AZHB dhe MBPZHR-së; Vendimi nr. protokoll 867 i datës 19.02.2020, për pezullim parandalues; Vendimi nr. protokoll 1190 i datës 06.03.2020, për pezullim parandalues ;Vendimi nr. protokoll 3556/2 i datës 08.10.2020, për lirim nga shërbimi civil, me dorëheqja sipas Kërkesës njoftuese të datës 09.09.2020; Vendimi nr. protokoll 187 i datës 20.01.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak arritjes së moshës së pensionimit, Vendimi nr. protokoll 187/2 i datës 07.02.2020, për kompensimin e një page të menjëhershme me rastin e pensionimit; Vendimi nr. protokoll 183 i datës 20.02.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak arritjes së moshës së pensionimit, Vendimi nr. protokoll 183/2 i datës 07.02.2020, për kompensimin e një page të menjëhershme me rastin e pensionimit; Vendimi nr. protokoll 186 i datës 20.01.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak

arritjes së moshës së pensionimit, Vendimi nr.protokolli 186/2 i datës 07.02.2020, për kompensimin e një page të menjëhershme me rastin e pensionimit; Vendimi nr.protokolli 184 i datës 20.01.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak arritjes së moshës së pensionimit, Vendimi nr.protokolli 184/2 i datës 07.02.2020, për kompensimin e një page të menjëhershme me rastin e pensionimit; Vendimi nr. protokolli 2689 i datës 09.07.2020, ndërprerja e marrëdhënies së punës me kohë të caktuar, i angazhuar me kohë të caktuar deri sa të kthehet nëpunësja civili nga pushimi i lehonisë; Forma tabelorë e nëpunësve të pensionuar, përfundim të marrëdhënies së punës me dorëheqje e tij për vitin 2020;Plani i trajnimeve për nëpunësit civil 2020, i datës 03.02.2020 nr.protokolli 548, bashkangjitur formularin në formën e tabelës ;Kërkesë e datës 10.01.2020 nr.protokolli 35 për punë jashtë orarit, me vendimet si në vijim; Vendimi nr. Protokolli 36/2 i datës 13.01.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Kërkesë e datës 10.01.2020 nr.protokolli 36 për punë jashtë orarit, të bashkangjitur forma tabelare e llogaritjeve të orëve të punës, si dhe lista e nxjerrë nga sistemi elektronik i hyrje dhe dalje; Kërkesë e datës 27.03.2020 nr.protokolli 1461 për punë jashtë orarit, të bashkangjitur forma tabelare e llogaritjeve të orëve të punës, si dhe lista e nxjerrë nga sistemi elektronik i hyrje dhe dalje; Vendimi nr.protokolli 1461/2 i datës 01.04.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; vendimi nr.protokolli 1018/2 i datës 05.03.2020, me Kërkesë e datës 28.02.2020 nr.protokolli 1018, të bashkangjitur forma tabelorë e llogaritjeve të orëve të punës, Email i datës 28.02.2020, lista e nxjerrë nga sistemi elektronik i hyrje dhe dalje; Vendimi nr.protokolli 553/2 i datës 17.03.2020, me Kërkesë e datës 03.02.2020 nr.protokolli 553 të bashkangjitur forma tabelorë e llogaritjeve të orëve të punës, Email i datës 24.01.2020, lista e nxjerrë nga sistemi elektronik i hyrje dhe dalje; Vendimi nr.protokolli 4905/2 i datës 04.12.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Vendimi nr.protokolli 4357 i datës 03.11.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Vendimi nr.protokolli 4358 i datës 03.11.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Vendimi nr.protokolli 4356 i datës 03.11.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Vendimi nr.protokolli 4408 i datës 05.11.2020, për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Vendimi nr.protokolli 4371/2 i datës 05.11.2020, , për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës; Vendimi nr.protokolli 1690/2 i datës 23.04.2020, me Kërkesë e datës 22.04.2020 nr.protokolli 1690 të bashkangjitur forma tabelorë e llogaritjeve të orëve të punës, dhe lista e nxjerrë nga sistemi elektronik i hyrje dhe dalje;Vendimi nr.protokolli 3206 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 3207 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 3208 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 3209 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 3210 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 3211 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 3212 i datës 07.08.2020, për shpërblimin e përvjetorit (jubilarë);Vendimi nr.protokolli 4372/3 i datës 05.11.2020, për rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës me rastin e vdekjes, bashkangjitur Vendimi nr. Protokolli 4372/4 i datës 06.11.2020;Vendimi nr.protokolli 1253/2 i datës 12.03.2020, për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, bashkangjitur njoftimin e datës 11.03.2020;Vendimi nr.protokolli 210/2 i datës 06.03.2020, bashkangjitur njoftimin nr.1253 e datës 11.03.2020, të bashkangjitur; Njoftim nr.3793 i datës 23.09.2020, me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, Vendimi nr.protokolli 3793/2 i datës 25.09.2020, për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, bashkangjitur njoftimin e datës 23.09.2020;Njoftim nr.123 i datës 15.01.2020, me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, Vendimi nr.protokolli 126/2 i datës 20.01.2020, për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të



familjes, bashkangjitur njoftimin e datës 15.01.2020; Njoftim nr.767 i datës 13.02.2020, me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, me Vendimin nr.protokolli 1593 i datës 10.04.2020, për ndarjen e mjeteve financiare; Vendimi nr.protokolli 1593 i datës 10.04.2020, për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, bashkangjitur njoftimin e datës 13.02.2020; Njoftim nr.protokolli 06/2 i datës 12.02.2020, nga Prokuroria e Shtetit, lidhur me ngritjen e aktakuzë së nëpunësin civil, bashkangjitur Vendimi i datës 02.03.2020 nr. Protokolli 746/2 nga Komisioni për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave; Kërkesë nr. Protokolli 3105 për pensionim të parakohshëm, i datës 07.08.2020, bashkangjitur Vendimi nr.protokolli 3237 i datës 10.08.2020; Prova shtesa nga vizita e monitorimit të datës 08.02.2022, duke bashkangjitur trajnimet dhe raportet nga vizitat studimore jashtë vendit, si në vijim: Lista e pozitive të lira, pesë (5) pozita "Zyrtar për komunitete"; "Zyrtar i lartë", Udhëheqës i Divizionit për Asistencë Teknike komunikim & publikim", "Udhëheqës i Divizionit për Paralajmërim të sëmundjeve", dhe "Zyrtar i lartë për analiza Socio-Ekonomike"; Tabela e ndryshimit buxhetit; Tabela-lidhur me të dhënat e kërkesave për udhëtime brenda vendit dhe jashtë vendit nga data 01.01.2020-31.12.2020, gjithsejtë 40 udhëtime, dhe janë nxjerrë pjesërisht raportet.

Këshilli për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim.

## 1. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2020, me datë 01.02.2022, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr.37/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës si dhe Strukturën Organizative të MBPZHR-së.

Në këtë institucion me buxhet janë planifikuar 189 nëpunës civil, ndërsa 5 pozita janë të lira. Të punësuar në janar 2020 gjithsejtë 154 nëpunës civil, 141 Shqiptar, 10 Serb, 8 Boshnjakë, prej tyre në aspektin gjinor janë 69 femra dhe 76 meshkuj. Në dhjetor të vitit 2020 gjithsejtë 146 nëpunës civil të punësuar, prej tyre 133 Shqiptar, 10 Serb, 3 boshnjak e te tjerë, në aspektin gjinor 65 femra dhe 81 meshkuj.

Gjatë vizitës së monitorimit, Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil, nga të cilat janë marrë disa kopje, mostër prej dy (2) dosjeve.

Kurse nga pesë (5) dosjet e monitoruara gjatë vizitës janë shqyrtuar këto pozita si në vijim, pozitat: "Udhëheqës i Divizionit për Verëtarë - DVV", "Drejtoresh e Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave", "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Fushore të Ekstensionit", "Udhëheqës i Divizionit për Analiza Ekonomike", "Zyrtar i lartë i Politikave Bujqësore" dhe "Asistent Administrativ". Pas analizimit të dosjeve Kolegji ka konstatuar se dosjet e personelit kanë qenë pjesërisht të kompletuara në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

**E GJETURA 1:** Këshilli për monitorim, zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar se në dosje gjenden pjesërisht të vendosura formularët e përmbajtjes së dosjes personale të nëpunësit civil, kurse formularët e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020 janë pjesërisht të përfunduara, sipas deklaratimit të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, nëntë (9) nëpunës nuk janë vlerësuar për vitin 2020 nga mbikëqyrësit e tyre të drejtë për drejtë, si dhe pozita "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Fushore të Ekstensionit", nuk është vlerësuar për periudhën nga data 01.09.2020 deri me datë 31.12.2020, sepse në dosje gjendet vetëm formulari i vlerësimit të rezultateve të punës për periudhën nga janar-gusht 2020, i nënshkruar me datë 31.08.2020.

Andaj, në bazë të këtyre të gjeturave Kolegji vlerëson se janë respektuar pjesërisht dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.17 të Rregullores Nr.03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil, dhe dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, respektivisht shtojcës 1.1 pika 17 të kësaj rregulloreje, sepse dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, ndërsa Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale, e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni. Po ashtu dosjet e personelit duhet të jenë të kompletuara, sipas përmbajtjes që kërkohet në shtojcën 1.1 të kësaj rregulloreje.

Po ashtu, mirëmbajtja e dosjeve të personelit të nëpunësve civil dhe dokumentet e tjera me rëndësi për Shërbimin civil dhe punësimet e tjera të krijuar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149) duhet të ruhen dhe të përfshihen në dosjet e reja personale, dosja e vlerësimit të nëpunësit civil, të bëra sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), do të mbahet, duke bërë rifreskimin e dosjeve të ngarkuara.

**Rekomandimi 1:** Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes së lartcekur, që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, si dhe nenin 83 paragrafi 13 dhe 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

**Pozitat e Ushtruesve në detyrë:** Kolegji gjatë monitorimit është bazuar në dëshmitë e ofruara të Njesisë së personelit, dhe ka konstatuar se në këtë institucion ka pasur shtatë (7) pozita me ushtrues detyre, mirëpo pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë respektuar procedurat ligjore dhe nuk ka tejkalim të afatit, me rastin e caktimit të ushtruesve në detyrë sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, jo më shumë se tre (3) muaj.

Këshilli për Monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil konstaton se lidhur me caktimin e ushtruesve në detyrë është zbatuar afati ligjor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me Aktgjykimin nr.KO203/19, të Gjykatës Kushtetuese, janë zbatuar dispozitat ligjore duke marrë për bazë që

pozitat e nivelit drejtues të zëvendësohen nga nëpunësit civil, në pajtim me nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërorë dhe të Agjencive të Pavarura.

**Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.**

Kolegji gjithashtu ka monitoruar edhe çështjen e deklaramit të statusit të zyrtarëve publik ndërsa është konstatuar se nuk kemi të përfunduar këtë proces përkundër që ka pasur lëvizje nga institucioni për të definuar këtë çështje.

**E GJETURA 2:** Bazuar në deklaramet e Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e cila ka deklaruar se është dërguar deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë, në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë tek Ministria e Punëve të Brendshme, dhe ende nuk ka marrë përgjigje nga ministria përgjegjëse për të plotësuar apo korrigjuar deklarimin e statusit, dhe mbi këtë bazë është gjetur se nuk është nxjerrë vendimi për deklarimin e statusit të nëpunësve civil në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga njësia përgjegjëse, bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik.

**REKOMANDIMI 2:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes me rastin e deklarimit të statusit të nëpunësve civil, duke obliguar Njësinë përgjegjëse që të përmbushë detyrimin sipas këtij rekomandimi, siç parashihet me dispozitat e nenit 83 paragrafi 16 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 2 dhe 3 Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik.

## **2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka përgatitur planin e personelit për vitin 2020, ndërsa gjatë vitit 2020 nuk ka pasur procedura të rekrutimit dhe avancimit. Po ashtu në këtë institucion nuk është lidhur asnjë kontratë me marrëveshje për shërbime të veçanta gjatë këtij viti.

**Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.**

## **3. PROCEDURAT DISIPLINORE**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka pasur tri (3) procedura disiplinore të zhvilluara, ka të themeluar Komisionin Disiplinor, bazuar në Vendimin me numër protokollit 4056 i datës 13.10.2020 me nr. ref.ZSP:969/20, i cili është formuar prej tre (3) anëtarëve, mirëpo me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka bërë shfuqizimin e këtij vendimi. Procedurat e iniciuara sipas kërkesave për komision disiplinor janë përfunduar në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Bazuar në nenin 49 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë , ku është përcaktuar që Qeveria, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për Administratën Publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, kështu që me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushe, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të Komisionit Disiplinor. Bazuar në nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: Nëpunës civil i nivelit drejtues -Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional -anëtar dhe Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore - anëtar”*. Me që kjo dispozitë ka përcaktuar se duhet të përshkruhen edhe pozitat e kryesuesit dhe anëtareve të Komisionit Disiplinor, atëherë Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka përmbushur këtë dispozitë në pajtim me dispozitën e lartë cekur.

**Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.**

#### **4. PROCEDURAT E ANKESAVE**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të provave të marra nga vizita me rastin e monitorimit, ka gjetur se për vitin 2020 janë shqyrtuar tri(3) raste nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, të cilat pasi që janë analizuar është konstatuar se janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Formuar Vendimi Nr. protokoll i 4857 i datës 03.12.2019 mbi themelimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ka bërë shqyrtimin e vendimit dhe konstaton se themelimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, është themeluar me tre (3) anëtareve të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar ka qenë në pajtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka shqyrtuar tri (3) raste të ankesave të zhvilluara nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave. Për këtë periudhë Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, është shuar Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, dhe mbi këtë bazë, gjatë monitorimit kemi gjetur se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka nxjerrë tri (3) Vendime për tri rastet të cilat me tutje janë shqyrtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ankuesit kanë parashtruar ankesë.

**Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.**

#### **5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pjesërisht ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil pasi që nëntë(9) nëpunës civil nuk janë vlerësuar për vitin 2020 edhe pse Njësia e Burimeve Njerëzore i ka njoftuar përgjegjësit e institucionit se vlerësimi i rezultateve të punës për nëpunësit civil, duhet të kryhet deri më 31 dhjetor 2020. Po ashtu për nëntë(9) nëpunës civil, për vitin 2020 nuk janë përfunduar vlerësimet e periudhës provuese. Lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këto të gjetura:

**E GJETURA 3:** Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se gjatë monitorimit të dosjeve të personelit ka gjetur se në dosje ka formular të

vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2020 që nuk janë gjetur në dosjen e nëpunësve civil, nëntë (9) nëpunës civil nuk janë vlerësuar për vitin 2020 nga mbikëqyrësit e tyre të drejtë për drejtë, si dhe pozita "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Fushore të Ekstensionit", nuk është vlerësuar për periudhën nga data 01.09.2020 deri me datë 31.12.2020, sepse në dosje gjendet vetëm formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën nga janar-gusht 2020, i nënshkruar me datë 31.08.2020, dhe mbi këtë bazë kemi shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, sepse vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësi civil, do të duhej të përfundoj të vendosen në dosjen personeli për periudhën kohore të vitit 2020 deri më datë 31 Janar të vitit të ardhshëm për vitin paraprak. Sepse në këtë rast nëse nuk bëhet përfundimi i vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit civil të pa vlerësuar mund t'ju njihet vlerësimi i njëjtë me atë të vitit të fundit, për vitin paraprak, nëse udhëheqësi i drejtpërdrejt nuk ka bazë ligjore të arsyeshme për mos kryerjen e obligimit të tij ligjor, lidhur me mos vlerësimin e rezultateve në punë, të nëpunësve civil brenda afatit ligjor.

Gjithashtu nëpunësit civil që për herë të parë kanë themeluar marrëdhënie të punës, është gjetur se nuk janë të nënshkruar formularët mbi konfirmimin e periudhës provuese nga ana e tyre por vetëm nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejte.

**Rekomandimi 3:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të gjitha vlerësimet e rezultateve në punë të bëhen brenda afateve të përcaktuar me nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, poashtu të sigurohet se të gjithë nëpunësit civil janë vlerësuar nga menaxheret drejtues siç përcaktohet me dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë

## 6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, për të gjitha llojet e pushimeve dhe janë zbatuar procedurat e pushimeve të lartcekura në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, si dhe Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

**E GJETURA 4:** Këshilli për monitorim të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se sipas të dhënave për vitin 2020, gjatë shqyrtimit të dosjeve sa i përket pushimeve ka vërejtur se nëpunësit civil edhe pse realizojnë pushimet vjetore, kërkesat ende bëhen dhe mbahen në forme fizike dhe se nuk regjistrohen në sistem elektronik, kërkesat dhe aprovimet e tyre.

**Rekomandimi 4:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të rekomandoj nëpunësit kompetentë, që evidenca e të gjitha pushimeve për nëpunësit civil të bëhet në formë elektronike përmes sistemit SIBMNJ, si dhe të ju mundësohet nëpunësve civil qasja në këtë sistem elektronike të SIBMNJ, për paraqitjen e kërkesave për llojin e pushimit sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë si dhe dispozitave tjera që rregullojnë çështjen e pushimeve të zyrtarëve publik.

## 7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë vitit 2020, ka pasur gjithsejtë njëzete e tre (23) transferime të përkohshme, dhe 1 transferim të përhershme të cilat kanë qenë të brendshme.

Në bazë të shqyrtimit të dosjeve, konstatohet që janë respektuar procedurat e parapara të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse nga provat e lëndës konstatohet se vetëm një transferim ka qenë i përkohshëm sipas këtij ligji, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publik, sipas Aktgjykimit nr.KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese, kanë qenë gjithsejtë 22 transferime të përkohshme brenda institucionit me afat të caktuar, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 52 të Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 4 dhe 5 i Rregullores (QRK)Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

## 8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka të punësuar në janar 2020 gjithsejtë 154 nëpunës civil, 141 Shqiptar, 10 Serb dhe tre të tjerë, në aspektin gjinor 69 femra, 85 meshkuj. Në dhjetor të vitit 2020 gjithsejtë 146 nëpunës civil të punësuar, prej tyre 133 Shqiptar, 10 Serb dhe tre të tjerë, në aspektin gjinor 65 femra dhe 81 meshkuj, ndërsa nëpunës civil me nevoja të veçanta është një (1) të deklaruar në këtë institucion. Në bazë të vlerësimeve në këtë fushë është konstatuar kjo e gjetur:

**E GJETURA 5:** Këshilli për monitorimit e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej të dhënave të fundit për vitin 2020 janë 146 nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prej tyre të punësuar 65 femra dhe 81 janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

**Rekomandim 5:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

**E GJETURA 6:** Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej të dhënave të fundit për vitin 2020, janë 146 nëpunësve civilë të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kanë vetëm një të punësuar nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbimin civil së paku një nëpunës duhet me qenë person me Aftësi të Kufizuara.

**Rekomandimi 6:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

## **9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS**

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka nëpunës që ka realizuar të drejtën e pezullimit të dakorduar. Në bazë të vlerësimit të dosjeve një (1) nëpunës civil ka marr pushim pa pagesë, një(1) nëpunës civil ka dhënë dorëheqje, dy (2) me pezullime parandaluese ,një(1) lirim nga marrëdhënia e punës me dorëheqje dhe një (1) përfundim i marrëdhënies së punës me rastin e vdekjes. Në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar se katër (4) nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së pensionimit të cilëve i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi. Poashtu një nëpunës civil që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak dorëheqjes sipas kërkesës së nëpunësit civil, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## **10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë ndonjë post publik.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## **11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS**

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka pasur dy (2) raste të nëpunësve civil në vitin 2020 që është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj të cilëve zyrtarë janë ndërmarrë veprimet administrative konformë legjislacionit në fuqi të shërbimit civil.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## **12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore, e ka përgatitur planin individual të trajnimeve në të cilin përfshihen fushat trajnimit (Formular 3) siç përcaktohet me Manualin e Metodologjisë së Vlerësimit të Nevojave për Trajnim në SHCK, po ashtu mbanë evidencën e trajnimeve të nëpunës civil, me raport final nga NBNJ. Lidhur me këtë fushë kemi konstatuar se nuk ka të gjetur.

**Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.**

## **13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vijimi në punë mbahet në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohen në pajtim me akt emërimet, kompensime të nëpunësve civil ka pasur në disa raste, si në vijim: me vdekjen e anëtarit të familjes, kanë pasur 7 raste të pagesës jubilarë për nëpunësit civil, dhe 17 raste të kompensimit për punë jashtë orarit të punë, të bashkangjitur në raport janë edhe vendimet dhe lista e nëpunësve civil të kompensuar.

**Në këto dy fusha të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime**

## **14. NGACMIMET SEKSUALE**

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast sa i përket kësaj çështje dhe nuk kemi ndonjë rekomandim.

## **15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT**

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë vitit 2020 nuk ka pas asnjë vendim të Këshillit për tu zbatuar.



**16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionet e Përgjithshëm për  
PROCEDURAT e MONITORIMIT të INSTITUCIONEVE të ADMINISTRATËS  
PUBLIKE LIDHUR ME ZBATIMIN e RREGULLAVE DHE PARIMEVE të  
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL**

Këshilli gjatë shqyrtimit të provave dhe disa dosjeve me rastin e vizitës në këtë institucion, për fushat e monitorimit, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

**Zyle Millaku GOJNOVCI**

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**I dërgohet:**

- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- ❖ Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.